



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 25.06.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “FIDERAT V4 DHE V5 QË DALIN NGA N/ST I RI VALIAS”, ME VENDNDODHJE NË BASHKITË KAMËZ, VORË DHE TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Operatorit të Sistemit të shpërndarjes OSSH” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Fiderat V4 dhe V5 që dalin nga N/ST i ri Valias”, me vendndodhje në Bashkinë Kamëz, Vorë dhe Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Operatorit të Sistemit të shpërndarjes OSSH” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kamëz, Vorë dhe Tiranë.
4. Vendimi Nr. 65, date 25.09.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Fiderat V4 dhe V5 që dalin nga N/ST i ri Valias”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga kryetari, ministri i Shëndetësisë dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALEUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 25/09/2025